




Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Autoriteti i Konkurrencës
Autoritet za Konkurenciju - Competition Authority



Nr.37/24
Prishtinë, më 08.04.2024

Komisioni i Autoritetit të Konkurrencës i Republikës së Kosovës në mbështetje të nenit 26, nenit 27, nenit 29, nenit 35, nenit 36 paragrafi 6 neni 39 si dhe neni 55 paragrafi 2 me nën paragrafin 2.4, i Ligjit Nr. 08/L-056 për Mbrojtjen e Konkurrencës, Ligji Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, bazuar në propozim/kërkesën nga ndërmarrja Kastrioti Sh.p.k. kundër Ndërmarrjes Barileva Trade, në mbledhjen e mbajtur me datën 08.04.2024 merr këtë:

KONKLuzion

Autoriteti i Konkurrencës i Republikës së Kosovës, konkludon se nuk është kompetent për të shqyrtuar ankesën e ndërmarrjes Kastrioti Sh.p.k, sipas Ligjit Nr. 08/L-056 për Mbrojtjen e Konkurrencës, bazuar në nenin 55 paragrafi 2 nën paragrafi 2.6.

Arsyetim

Autoriteti i Konkurrencës i Republikës së Kosovës, me datën 15.02.2024, me Nr. Prot. 102/24 01/H, ka pranuar propozim/kërkesën nga ndërmarrja Kastrioti Sh.p.k. me pretendimin kundër ndërmarrjes Barileva Trade adresa: Barileve. për shkaktimin e konkurrencës së padrejtë për linjën e transportit urban të udhëtarëve në Komunën e Obiliqit.

Pretendimet e paraqitësit të iniciativës:

Ndërmarrja Kastrioti Sh.p.k është ndërmarrje e cila kryen shërbimin e transportit të rregullt të udhëtarëve me autobus në linjën Obiliq – Prishtinë dhe anasjelltas. Kjo linjë funksionon në bazë të marrëveshjes së dy komunave KK Obiliq dhe KK Prishtinë, që nga viti 2006 e tutje, duke përfshirë edhe rregulloren e KK Prishtinë për përcaktimin e linjave dhe itinerarit të transportit urban të rregullt të udhëtarëve në territorin e KK Prishtinë(mars 2006).

Sipas ankuesit operatori ekonomik, në bazë të këtyre rregulloreve të lartcekura dhe linjave të miratuara nga KK Prishtinë nuk ka linjë të miratuar për relacionin Barilevë, Obiliq, Prishtinë dhe anasjelltas. Prandaj ky operator ekonomik, kompanisë tonë i shkakton konkurrencë të padrejtë. Kjo linjë sipas marrëveshjes së dy komunave ndahet në dy pjesë për mbulim të saj është që 50% është operator nga Prishtina dhe 50% operatori nga Obiliqi. Kjo në bazë të marrëveshjes është që kompania Kastrioti shpk të mbuloj, kurse 50% e operatorit nga Prishtina e mbulon Trafiku Urban. Por në mungesë të autobusëve të Trafikut Urban është arritur një marrëveshje që kompania Kastrioti shpk, ti shfrytëzoj 50% të nisjeve nga Prishtina(me qera). Dëshmi është marrëveshja në mes KK Prishtina dhe Trafiku Urban.

Konkurrenca jo e drejtë që i bëhet kompanisë tonë nga ky operator në bazë të dokumenteve dhe rregulloreve që janë në fuqi që nga viti 2006. Ky operator është ilegal në këtë linjë dhe dëmi i cili shkaktohet në konkurrencë, kjo nënkupton se operatori i lartcekur e shfrytëzon këtë linjë i paautorizuar nga organi kompetent për dhënie të rend udhëtimit ku i krijon mundësi vetit në caktimin e çmimit jo real të tregut joproportionalisht me shpenzimet e operimit. Si dëshmi është rregullorja e KK Prishtinë për caktimin e linjave, linja nr 11 dhe linja nr. 12.

Në dokumentacionin e paraqitur nga ankuesi kemi edhe aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike i cili e refuzon këtë ankesë me arsyetimin që nuk është kompetent në çështjen e ngritur juridike të paditësit N.SH. “Kastrioti”, kundër të paditurës Komuna e Obiliqit, me objekt kontesti kompensim dëmi.

Aktivitetet e zhvilluara në shqyrtimin e monitorimit paraprak të tregut përkatës

Autoriteti pas analizimit të kërkesës dhe konsultimit të legjislacionit ka shqyrtuar dokumentacionin e dorëzuar pranë Autoritet të Konkurrencës, me c ‘rast ka kryer shqyrtimin paraprak lidhur me kërkesën për konkurrencë jo të drejtë që i bëhet ndërmarrjes Kastrioti Sh.p.k në bazë të dokumenteve dhe rregulloreve që janë në fuqi nga viti 2006.

Autoriteti në dokumentacionin e paraqitur nga ndërmarrja ankuese ka pranuar formularin e ankesës, dokumentet identifikuese të ndërmarrjes, ankesat e ndërmarrjes edhe pranë komunave, si dhe marrëveshjen për rregullimin reciprok të transportit linjor të udhëtarëve. Kjo çështje nga ndërmarrja në fjalë është drejtuar edhe pranë Gjykatës themelore në Prishtinë, me c ‘rast është paditur Komuna e Obiliqit me objekt kontesti kompensim dëmi. Gjykata Themelore në Prishtinë ka shpallur aktvendim si jokompetent në çështjen juridike të paditësit N.SH. “Kastrioti” sh.p.k.

Analiza e Konkurrencës

Objektivi kryesor i politikës së konkurrencës është ruajtja e procesit konkurrues dhe nxitja e konkurrencës efektive në treg. Ruajtja ose nxitja e konkurrencës efektive është e domosdoshme, duke pasur parasysh kufizimet që sektori privat apo ai shtetëror/publik mund t’i bëjnë konkurrencës.

Prandaj ligji i konkurrencës ndalon marrëveshjet për fiksimin e çmimit, abuzimin me fuqinë dominuese, si dhe përqendrimit që rrezikojnë të krijojnë një pozitë dominuese në treg.

Mandati themelor i AKRK-së është mbrojtja e konkurrencës së lirë dhe kjo nënkupton që AKRK vepron kur cenohet, pengohet ose shtrembërohet konkurrenca në treg. Më konkretisht, Autoriteti i Konkurrencës reagon në ato raste kur ndërmarrjet veprojnë në mënyrë të koordinuar (pra, nëse një veprim i tillë është rezultat i marrëveshjes së tyre eksplicite, përmes formës së kartelit-marrëveshjes së ndaluar apo sjelljeve të tyre në treg - praktikës së bashkërenduar). Gjithashtu, AKRK mund të reagojë edhe ndaj ndërmarrjeve që kanë pozitë dominuese në treg dhe të cilët keqpërdorin këtë pozitë.

Autoriteti i Konkurrencës zhvillimin e procedurës e bazon në neni 35 – Propozimi për Fillimin i Procedurës dhe ex-officio neni 36 - Fillimi i Procedurës, dhe atë në rastet kur kemi të bëjmë me të gjitha format e parandalimit, kufizimit ose keqpërdorimit të konkurrencës nga ana e ndërmarrjeve që operojnë në tregjet përkatëse.

Kur ligjet e sektorit përkatës parashikojnë marrjen e masave të posaçme, si kontrolli i çmimeve ose aksesit në infrastruktura fizike, organet publike/komunat kanë detyrën dhe përgjegjësinë kryesore për të mbikëqyrur këta parametra të konkurrencës.

Në sektorët e rregulluar, zbatimi i ligjit të konkurrencës varet nga shkalla e konkurrencës që lejohet në treg. Në parim, nëse ligjet përkatëse fiksojnë parametrat kryesor të konkurrencës, duke mos lënë më vend për konkurrencë, ligji për mbrojtjen e konkurrencës nuk do të zbatohet, për arsye se legjislatori ka vendosur që mbrojtja e interesave të tjera publike justifikon uljen e shkallës së konkurrencës.

Si rrjedhojë e sa më sipër, Komisioni konstatoi se në rastin konkret nuk ka indikacione për fillimin e procedurës në kuptim të nenit 36 ndaj ndërmarrjes Barileva Trade. Për sa i përket vlerësimin të ligjshmërisë së veprimeve në përputhje me rregulloret e veçanta që rregullojnë fushën lëndore, Autoriteti i Konkurrencës, duke pasur parasysh kompetencat e saj ligjore, nuk është kompetente në zbatimin e ligjeve dhe rregulloreve të veçanta që rregullojnë veprimtarinë e ofrimit të shërbimeve, për caktimin e linjave dhe itinerarit të transportit urban të rregullt të udhëtarëve me autobus.

Autoriteti thekson se çdo kufizim ligjor apo faktik i numrit të operatorëve, të cilët janë potencial për t'u angazhuar në një veprimtari në një treg të caktuar (numerus clausus) në përgjithësi është e padëshirueshme nga pikëpamja e konkurrencës.

Nga sa më lartë, Komisioni i Autoritetit duke u bazuar në nenin 55 paragrafi 2 nën paragrafi 2.6 i Ligjit Nr. 08/L-056 për Mbrojtjen e Konkurrencës, u vendos si në dispozitiv të këtij Konkluzioni.

Obligohet Sekretariati që të kujdeset për zbatimin e këtij konkluzioni.

Ky konkluzion, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga ana Komisionit.

AUTORITETI I KONKURRENCËS

Komisioni

Neime Binaku - Isufi

Kryetare



Kaltrina Sela
Nënkryetare



Florent Mehmeti
Anëtar



Nafije Osdautaj
Anëtare



Salihe Gashi Loku
Anëtare



Këshilla juridike: Kundër këtij konkluzioni nuk është e lejuar ankesa, por pala me padi mund të iniciojë konflikt administrativ pranë Gjykatës kompetente për çështje administrative në afat prej 30 ditësh, nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ.

Me këtë KONKLUZION të njoftohen:

- Paraqitësi i Iniciativës
- Publikohet në web faqen e Autoritetit
- Arkiva